



# NJOFTIM PËR KONTRATË

## *Ri-tender*

### *Kontratë Shërbimi*

### *Procedure e hapur*

Në përputhje me nenin 10, "Procedura e hapur" të Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (1 dhjetor 2024)

Data: 19.12.2025

Nr. i Prokurimit: "BQK 25 069.1 221"

#### I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/451	Fax: 038 243 763

#### II LËNDA E KONTRATËS

##### II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Shërbime të pastrimit të objekteve të BQK-së"
Lloji i prokurimit: Shërbim
Vendi kryesor i realizimit: BQK Prishtinë dhe BQK Prizren
Informacione të marrëveshje afatgjatë: Po Kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi
Variantet pranohen: Jo
Vlera e parashikuar e kontratës vjetore: 55,000.00 euro
Afate të shkurtuara kohore: Po (në përputhje me nenin 25 të Rregullës për Prokurimin në BQK)

Ndarja në Pjesë: JO

### III INFORMACIONE PËR SHERBIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhet kontraktuesi i cili do të ofroj në mënyrë profesionale shërbimet e pastrimit të objekteve të BQK-se, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t'u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

### IV KRITERET E PËRZGJEDHJES<sup>1</sup>/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

<i>Përshtatshmëria e Operatorëve Ekonomik – Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2, 3 dhe (4 në rast se aplikohet)) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i>	<b><u>Kërkesa 1:</u></b> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.
	<b><u>Evidenca 1:</u></b> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin përkatës të dosjes së tenderit.
	<b><u>Kërkesa 2:</u></b> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”
	<b><u>Evidenca 2:</u></b> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
	<b><u>Kërkesa 3:</u></b> Deklaratë me shkrim se do të angazhoni 7 punëtor, paga për të cilët do të bëhet sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.
	<b><u>Evidenca 3:</u></b> Deklaratë origjinale me shkrim e lëshuar nga ofertuesi/operatori ekonomik, me zotimin sipas kërkesës së lartpërmendur, e nënshkruar dhe e vulosur.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në pikat 1, 2 dhe 3.

<sup>1</sup> Sipas nenit 32 të Rregullës për prokurimin në BQK “Kriteret e për zgjedhjes”

	<p><b>Kërkesa 4:</b> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)</p> <p><b>Evidenca 4:</b> Nëse tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë tenderimi. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të Rregullës për Prokurimin në BQK.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 5, 6 dhe 7) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><b>Kërkesa 5:</b> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><b>Evidenca 5:</b> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><b>Kërkesa 6:</b> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><b>Evidenca 6:</b> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><b>Kërkesa 7:</b> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><b>Evidenca 7:</b> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 5, 6 dhe 7.</p>

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Nuk aplikohen
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – <i>Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 8, 9, 10 dhe 11) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i>	<p><b><u>Kërkesa 8.</u></b> Ofertuesi duhet ta plotësoj formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><b><u>Evidenca 8.</u></b> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me shërbimet e ngjashme të realizuara ne tri vitet e fundit duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumen e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej shërbimeve;</p> <p><b><u>Kërkesa 9:</u></b> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata të ngjashme (pastrim i brendshëm i objekteve) gjate 3 (tri) viteve të fundit (2023, 2024 dhe 2025 deri në dorëzim të ofertës)</p> <p><b><u>Evidenca 9:</u></b> Ofertuesi duhet te ofroj si dëshmi:</p> <p>a) certifikatat përkatëse ose referencat qe evidentojnë realizimin e shërbimit të tillë dhe</p> <p>b) kopjet e kontratave përkatëse.</p> <p><b><u>Kërkesa 10:</u></b> Ofertuesit duhet të dorëzojnë listën ose katalogun me produktet higjienike të ofertuara.</p> <p><b><u>Evidenca 10:</u></b> Katalogu ose lista me foto dhe përshkrim e produkteve për pastrim, me cilësi të lartë dhe që përmbushin standardet relevante të kualitetit dhe kriteret ekologjike.</p> <p><b><u>Kërkesa 11:</u></b> Ofertuesi duhet të jetë i akredituar nga institucioni i pavarur sipas ISO standardeve, për Certifikimin e sigurisë dhe shëndetit në punë</p> <p><b><u>Evidenca 11:</u></b> Kopje e certifikatës.</p>
Inspektimi i kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale të ofertuesit	<p>Banka Qendrore mundet që në fazën pas pranimit të ofertave dhe gjatë vlerësimit të tyre, me shpenzimet e saj, të kryej një inspektim të operatorëve ekonomik tenderues për qëllime të verifikimit të kapaciteteve disponuese të tyre për vërtetimin e cilësisë, punën e tyre në vend sipas referencave, mjetet për transport dhe çdo informatë tjetër te nevojshme qe mund te dëshmoj qe ofertuesi mund ta realizojë kontratën.</p> <p>Për produktet higjienike të cilat i ofron tenderuesi me oferte sipas kërkesës 10 më lartë) Banka Qendrore mund të beje inspektim për të vlerësuar për së afërmi kualitetin e kërkuar.</p>

V.1 Lloji i procedurës: “*Procedurë e hapur*” (në përputhje me nenin 10 të Rregullës për prokurimit në BQK)

VI. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “*Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët*” (në përputhje me nenin 34 të Rregullës për prokurimit në BQK)

#### VII. INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e dosjes se tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 24.12.2025, ora 12:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a> .
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 24.12.2025, ora 14:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a> .
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave: 26.12.2025, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave: 26.12.2025, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Garibaldi” nr.33, Prishtinë.
Aplikohen afate të shkurtuara kohore sipas nenit 25, e Rregullës për Prokurimin në BQK.
Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): 1,000.00 € (një/mijë/euro) me vlefshmëri prej 90 ditësh nga data e hapjes së ofertave (të dorëzohet me ofertë)
Kushti i sigurimi të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 60 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes
Dokumentet me pagesë: Jo

#### VIII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org), brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

## IX. ADRESA

Rr. "Garibaldi" nr. 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL ( <i>nëse aplikohet</i> ): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/451	Fax: 038 243 763